



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI JURIDIK

Nr. _____ Prot

Tiranë më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E SISTEMEVE”
Per nevojat e shoqerise Illyrian Guard SH.A

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** 72267100-0 -Mirmbajtja e softwareve te teknologjise se informacionit
- **VLERA E FONDIT LIMIT:** 46,824,000(Dyzet e gjashte milion e teteqind e njezet e kater mije) **LEK PA TVSH dhe 479,067 (katerqind e shtatedhjete e nente mije gjashtedhjete e shtate) euro pa TVSH**
- ***Shënim** :Vlerat ne leke jane konvertuar ne monedhen euro me kursin zyrtar te kembimit te Bankes se Shqiperise me date 16.07.2025 me kurs kembimi 97.74 (nenetedhjete e shtate pike shtatedhjete e kater) leke.
- Sigurimi i ofertës 2% 936,480 (Nenteqind e tridhjete e gjashte mije e katerqind e tetedhjete) lekë dhe 9,581.34(nente mije e peseqind e tetedhjete e një pikë tridhjete e kater) Euro e fondit limit sipas nenit 30, pika 3, te VKM nr.285, datë 19.05.2021

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe

nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit Nr. Prot 838 ,datë 03.07.2025, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **“SHPENZIME PER MIREMBAJTJEN E SISTEMEVE”** për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A.

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

I.ARGUMENTIMI I MOS NDARJES NË LOTE

Në bazë të nenit 39, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” date 23.12.2020,i ndryshuar të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor ka vendosur qe kjo procedure te mos jete ne lote sipas arsytimit te meposhtem:

Kjo kontratë nuk është ndarë në lote pasi ofrimi i shërbimit objekt kontrate është për **mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë që** do të administrohet dhe monitorohet Salla e Monitorimit në Tiranë ndaj dhe ndarja dhe frangmentimi i saj do të krijonte kompleksitet dhe vështirësi në zbatim si dhe do e bënte të pazbatueshme kontratën.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Sipas procesverbalit bashkelidhur.

III. ARGUMENTIMI VLERA LIMIT E KONTRATËS,

Në përlllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, **Autoriteti ynë kontraktor**, ka zbatuar parashikimet e Nenit 76 të VKM nr.285 pika 1 b duke marrë oferta nga operatorët ekonomik të fushës. Ofertat janë administruar në procesverbalin e llogaritjes së fondit limit dhe janë pjesë e dosjes.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe*
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

AFATI I OFRIMIT TË SHËRBIMIT: do të jetë për 12 (dymbëdhjetë) muaj kalendarike nga momenti i përfundimit të kontratës në zbatim/ ose nga fillimi i ofrimit të shërbimit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, "Formulari përmbledhës i vetdeklarimet" dhe Nenit 83 "Sigurimi i ofertës" të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" citohet: "*Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*", Në Nenin 82, të LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve të fundit 2022, 2023 dhe 2024, **ku të paktën në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më pak se 80% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke marrë në konsideratë specifikën e shërbimit objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohe dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete jo më e vogël se 80% të fondit limit sipas parashikimeve të pikës 2a të Nenit 43 të VKM i cili parashikon:

a) dyfishin e vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik ofertues duhet të vërtetojë që ka realizuar Shërbime të ngjashme, me vlerë jo më pak se 39 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për shërbime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”ose ekuivalent;

ISO 20000-1 “ Per teknologjine e informacionit » -Menaxhimin e shërbimit ose ekuivalent”

ISO 27001 ” Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalent”.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto çertifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve. Ky kriter kërkohej nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues të paraqesë licencën e sipercituar është menduar si i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, me qëllim për të siguruar AK që mallrat e ofruar do të jenë cilësorë dhe me parametra që plotësohen nga prodhues të licencuar sipas standarteve ndërkombëtare të cilësisë. Plotësimi i këtyre kritereve nga ofertuesit e interesuar, garanton realizimin me sukses dhe me cilësi të objektit të kontratës.

ISO 20000-1 “Per teknologjine e informacionit -Menaxhimi i shërbimit ” është thelbësore, dhe siguron menaxhimin e shërbimeve që parashikon kontrata. Ky lloj certifikimi garanton

Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka të implementuar një sistem menaxhimi të shërbimeve dhe zbatimin e kontratës në tërësi e rrjedhimisht dhe përmbushjen e saj sipas të gjitha standardeve të shërbimit. Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të IT konfirmon angazhimin e operatorit ekonomik për të ofruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e shërbimeve. Ofrimi i shërbimit, i përket fushës së teknologjisë së informacionit dhe është e nevojshme pajisja me këtë ISO nga kompania ofertuese për realizimin në mënyrë efikase dhe në përputhje me kërkesat e “Illyrian Guard” ShA. ISO 20000-1 është standardi ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimit të Teknologjisë së Informacionit (ITSM) i pranuar nga shumica e vendeve të botës. Standardi përshkruan një seri procesesh menaxhimi të krijuara për të ndihmuar kompanitë të ofrojnë shërbime më efektive të IT (si për ato brenda kompanisë ashtu edhe për klientët e tyre). E cila jep metodologjinë dhe kornizën për të ndihmuar kompanitë të menaxhojnë ITSM. Me kërkesat e standardit kompanitë aplikojnë praktikatat më të mira, duke ndihmuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve IT.

ISO 27001 ”Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit”- Ky standart është i nevojshëm për të garantuar zbatimin e kërkesave të sigurisë në ruajtjen dhe menaxhimin e informacionit . AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 27001 pas ofron mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike dhe rrjedhjeve të të dhënave, Besueshmëri më e madhe për klientët dhe partnerët, Përshtatje me kërkesa ligjore dhe kontraktuale, Përmirësim i menaxhimit të rreziqeve, Rritje e reputacionit të organizatës

2.3.3 Operatori Ekonomik për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve se ka jo më pak se 13 persona të punësuar për 3-Muajt e fundit të maturuara nga data e hapjes së tenderit, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 . në të cilën të përfshihen :

- Të paktën 2 (dy) inxhinierë të profileve Elektronik/Elektrik/Telekomunikacioni/informatike për të cilët duhet të paraqesi diplomën perkatese ose vërtetim diplome sipas ligjit;
- Të paktën 1(një) punonjës të pajisur me Certifikatë për Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute(P M I) ose ekuivalente;
- Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues** të sistemeve të vëzhgimit ose nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit ;
- Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues nga prodhues** të sistemeve të alarmeve ose nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit ;
- Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues** të sistemeve të akses kontrollit ose nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit ;

- për ofrimin e shërbimeve të mirmbajtjes së sistemeve duhet ketë pjesë të stafit të paktën 4 (kater) punonjes të deklaruar si **montues te pajisjeve elektronike** ose profesioneve ekuivalente dhe te pajisur me Certifikata Mbi sigurimin teknik per punonjesit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike apo në afërsi të tyre. Për këtë OE duhet të paraqesi një deklaratë me emrat e tyre , certifikatat e sigurimit teknik te leshuara nga autoritetet kompetente te akredituara dhe duhet të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqerore, shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi sipas formatit E-sig. për periudhën e 3-muajve te fundit sipas kodit përkatës të profesionit referuar VKM 514 datë 20.09.2017.

Sqarim! *Një punonjës mund të ketë 1 (një) ose disa certifikime për të përmbushur kriterin më sipër.*

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklarimit si:

- Certifikatat e mësipërme të vlefshme;
- Deklarata
- Diploma;
- Vertetim nga sigurimet
- Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4 paragrafi b) i VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e tyre te nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Konkretisht:

Disponimi i stafit me specialistët e sipërcituar gjykohet se është i domosdoshem në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të **Shërbimit objekt kontrate: shërbimi i mirëmbajtjes së sistemeve të kamerave, sistemeve të alarmit, sistemeve të akses kontrollit, barrierave elektronike (tra parkimi-tripod) radio , programe monitorimi etj** me shtrirje në të gjithë Shqipërinë, kohëzgjatjes të kontratës në 1 vit kalendarik. Të gjithë specialistët e kërkuar janë të nevojshem për realizimin e shërbimeve të kërkuara në specifikimet teknike të kësaj procedure. Disponimi i stafit teknik të kërkuar krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet profesional për realizimin e kontratës.

Konkretisht:

- a) 2 (dy) inxhinierë të profileve Elektronik/Elektrik/Telekomunikacioni : Janë kërkuar profesione ekuivalente në mënyrë që të zgjerohet konkurrenca mes operatorëve. Duke qenë se kemi të bëjmë me shërbim mirëmbajtje i i cili përshin një infrastrukturë voluminoze dhe pjesë e shërbimit është edhe zëvendësimi i pajisjeve të dëmtuara apo që nuk riparohen inxhinierët e profileve të mësipërme garantojnë zbatimin e kërkesave ligjore në lidhje me sigurinë teknike/sigurinë në punë/ mbikqyrjen e proceseve të riparimit dhe instalimit të sistemeve të kamerave, alarmit, aksesit, radiove etj të cilat janë pajisje elektronike /telekomunikacioni dhe do të funksionojnë nëpërmjet energjisë elektrike.
- b) (një) punonjës të pajisur me Certifikate per Menaxhimin e Projekteve Profesionale (Project Management Professional – P M P, PRINCE 2) lëshuar nga Project Management Institute(P M I) ose ekuivalente; Është kërkuar si kriter si garanci se operatori ekonomik ka në staf një person të certifikuar dhe me eksperiencë që do të jetë i angazhuar në menaxhimin e kontratës dhe koordinimin e punës në të gjithë territorin e vendit. Menaxheret e projektit janë përgjegjës për ndjekjen e të gjithë ciklit të një projekti implementimi, që prej analizës dhe dizenjimit të kërkesave, parametrizimeve dhe konfigurimeve të sistemit, testimit, trajnimit dhe dokumentimit të projektit. Projekt menaxheri, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit, afatet kohore të kryerjes së shërbimit, shumëllojshmërinë e shërbimeve të kërkuara, do të siguronte që çdo pikë e shërbimeve të kërkuara të kryhen me sukses dhe cilësi si edhe në kohë e afat sipas përcaktimeve të kësaj kontrate. Gjithashtu vlen të theksohet që me këtë numër minimal të kërkuar synohet të garantohet gjatë gjithë kohës ofrimi i shërbimit dhe prandalohen rastet e pamundësisë së prezencës së stafit për arsye të ndryshme objektive (leje vjetore, raport mjekësor, trajnime, etj).
- c) Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues** të sistemeve të vëzhgimit ose nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit ; Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në mirëmbajtjen rutinë të sistemeve të kamerave ndaj duhet të jenë të trajnuar nga prodhuesit në mënyrë që të njohin mallin .

Përfshirja e punonjësve të certifikuar nga prodhues të sistemeve të vëzhgimit ose autoritete të autorizuar përbën një element thelbësor për garantimin e cilësisë dhe sigurisë në projektimin, instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të mbikëqyrjes. Sistemet moderne të vëzhgimit janë komplekse, përfshijnë pajisje inteligjente (kamerat IP, sistemet e ruajtjes së të dhënave, softuerë të analizës video etj.), të cilat kërkojnë njohuri të specializuara për të siguruar një funksionim optimal. Punonjësit e certifikuar: Zotërojnë njohuri të avancuara teknike, të fituara përmes trajnimeve zyrtare nga vetë prodhuesit .Janë të përgatitur për të konfiguruar në mënyrë të sigurt pajisjet, përfshirë rregullimet e rrjetit, sigurinë kibernetike dhe parametrat e avancuar të sistemit. Sigurojnë përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, për sigurinë e informacionit dhe rregulloret kombëtare për mbrojtjen e të dhënave. Garantojnë instalim dhe mirëmbajtje efikase, duke minimizuar problemet teknike dhe kohën e ndërprerjes së shërbimeve. Përmbyshin kërkesat ligjore

dhe të sigurisë, pasi shumë autoritete rregullatore kërkojnë që vetëm persona të certifikuar të kryejnë punë në sisteme të sigurisë.

- d) Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues** të sistemeve të alarmeve ose nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit ;Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në mirëmbajtjen e sistemeve të alarmeve ndaj duhet të jenë të trajnuar nga prodhuesit në mënyrë që të njohin mallin . Sistemet moderne të alarmit përfshijnë pajisje të lidhura në rrjet, module komunikimi GSM/GPRS, lidhje me qendra monitorimi dhe integritet me sisteme të tjera të sigurisë (CCTV, etj.). Këto teknologji kërkojnë aftësi specifike teknike, të cilat mund të sigurohen vetëm përmes trajnimit dhe certifikimit të drejtpërdrejtë nga prodhuesi ose një autoritet ligjërish i njohur.Punonjësit e certifikuar janë trajnuar për konfigurimin dhe mirëmbajtjen e produkteve specifike. Ata janë të aftë të njohin në mënyrë të saktë karakteristikat teknike të pajisjeve, të diagnostikojnë defekte dhe të kryejnë ndërhyrje pa kompromentuar funksionin e sigurisë.Minimizimi i rreziqeve operationale dhe gabimeve.Përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat ligjoreCertifikatat e lëshuara nga prodhues ose trajnues të autorizuar sigurojnë që mirëmbajtja të kryhet në përputhje me protokollet dhe rregulloret teknike të miratuara ndërkombëtarisht si dhe me kërkesat e legjislacionit kombëtar.Kualifikimi i drejtpërdrejtë i personelit që do të angazhohet në terrenTheksi që punonjësit të jenë të drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik siguron që kompania nuk mbështetet te burime të jashtme apo të përkohshme, por ka kapacitet të brendshëm teknik për të garantuar mbulimin e vazhdueshëm të kontratës. Kjo ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, shpejtësinë e reagimit dhe sigurinë e shërbimit të mirëmbajtjes.
- e) Të paktën 2 (dy) punonjës **të certifikuar nga prodhues** të sistemeve të akses kontrollit ose nga autoritete të autorizuara/certifikuara për dhënien e tyre sipas ligjit Janë punonjësit e drejtpërdrejtë të operatorit ekonomik që do të angazhohen në mirëmbajtjen e sistemeve të aksesit .Kërkesa që **punonjësit të jenë pjesë e drejtpërdrejtë e stafit të kompanisë** që merr përsipër kontratën siguron:Vazhdueshmëri në shërbim,Përgjegjësi të qartë për ndërhyrjet teknike,Reagim të shpejtë dhe njohje të plotë të sistemit ekzistues, Certifikimi i të paktën 2 punonjësve për sistemet e akses kontrollit është një **garanci teknike** që operatori ekonomik zotëron kapacitetin e nevojshëm për të ofruar një shërbim të **besueshëm, të sigurt dhe të pajtueshëm me standardet** në fuqi. Kjo ndihmon në **minimizimin e riskut operacional** dhe garanton **funksionim të qëndrueshëm të sistemeve të aksesit** në çdo ambient të mbrojtur.

- f) Të paktën 4 (kater) punonjes të deklaruar si **montues te pajisjeve elektronike** ose profesioneve ekuivalente dhe te pajisur me Certifikata Mbi sigurimin teknik per punonjesit që punojnë me impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike apo në afërsi të tyre. Për këtë OE duhet të paraqesi një deklaratë me emrat e tyre , certifikatat e sigurimit teknik te leshuara nga autoritetet kompetente te akredituara dhe duhet të figurojnë në listpagesat e sigurimeve shoqerore, shëndetësore dhe të ardhurat nga punësimi sipas formatit E-sig. për periudhën e 3-muajve te fundit sipas kodit përkatës të profesionit referuar VKM 514 datë 20.09.2017. duke marrë në konsideratë volumin dhe shtrirjen e shërbimit të kërkuar montuesit e pajisjeve elektronike do të jenë pjesë e stafit që do të angazhohet gjatë procesit të mirëmbajtjes për problematika që nuk kanë lidhje me produktet por me elemntë të tjerë si rrjeti energjisë, fibra, shkëputjet e komunikimit etj . Certifikata Mbi sigurimin Teknik të këtyre punonjësve është një garanci që kanë marrë kualifikimin e duhur për të punuar me instalimet që kërkojnë energji elektrike. Punonjës të pa trajnuar mund të kryejnë lidhje të pasakta, të dëmtojnë pajisjet gjatë instalimit ose të shkaktojnë ngarkesa të rrezikshme për rrjetin elektrik. Punonjësit e certifikuar njohin **praktikat më të mira për montimin dhe lidhjen e sigurt**, duke garantuar që çdo instalim të përfundojë në përputhje me standardet e sigurisë elektrike. Përcaktimi i minimumit prej **katër (4) punonjësish** siguron që operatori ekonomik ka kapacitetet për të realizuar ndërhyrje të njëkohshme në disa ambiente ose të përballojë instalime të shumta pa vonesa.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë Suporti/Autorizim nga Prodhuesit ose Distributorët e Autorizuar të Sistemeve të vëzhgimit, alarmit dhe akses kontrollit sipas specifikimeve teknike për periudhën 1-vjecare të mirëmbajtjes.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë Suporti/Autorizim nga Prodhuesit ose Distributorët e Autorizuar të programeve të specializuara të monitorimit dhe menaxhimit të sistemeve të sigurisë sipas pikes 6 të Specifikimeve Teknike për periudhën 1-vjecare të mirëmbajtjes.

Në rast se do të paraqitet deklarate/ autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi/Deklarata duhet ti referohet procedurës konkrete dhe duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë 37, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që referuar specifikimeve teknike operatori ekonomik ofertues të marr përsiper mirëmbajtjen e sistemeve ekzistuese dhe të paraqesë një deklaratë suporti nga Prodhuesit e Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes aq sa është edhe afati i kohëzgjatjes së kontratës.

Referuar faktit se pajisjet janë të instaluar dhe kërkohet vetem mirëmbajtja dhe zëvendësimi i tyre me produkte të të njejtave marka, kërkesa për paraqitjen e një deklarate suporti nga Prodhuesit e Sistemeve të mësipërme për periudhën 1-vjeçare të mirëmbajtjes, krijon bindje tek Autoritetin Kontraktor se OE ofertues ka kapacitetet teknike të nevojshme dhe të kualifikuar për realizimin e kontratës.

Ky kriter shërben për të garantuar AK-në së OE ofertues janë operatorë të përshtatshëm dhe zotërojnë kapacitetet teknike të nevojshme për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë te pakten **3 (tre) automjete** për realizimin e instalimeve, për te cilët duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtem:

- Lejen e qarkullimit
- Policen e sigurimit
- Çertifikaten e kontrollit teknik
- Taksat vjetore

Ne rast se mjetet e lartpërmendura janë marre me qera ofertuesi duhet të paraqesë ***Kontratën e marrjes me qira të mjetit***, shoqëruar me dokumentacionin përkatës të pronësisë së mjetit që ka pronari, i cili e jep me qira. Kontrata e qirasë të jetë noteriale e të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 9, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Argumentimi: Ky kriter, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe tregon që ofertuesi ka kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 40, pika 5 germa ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa e mësipërme i shërben AK si garanci se operatori ekonomik fitues ka mjetet e nevojshme për të realizuar me sukses implementimin e kontratës brenda afateve.

Duke marrë në konsideratë se për realizimin me sukses të kësaj procedure do të kryhen shërbime mirëmbajtje në të gjithë vendin 3 automjete është numri minimal i nevojshëm që dëshmon

aftësinë e operatorit ekonomik për të bërë transportin e stafit dhe materialeve në pikat e shërbimit për grupet e punës çdo ditë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit